

Thirrje publike ndërkombëtare nr. 02/062012

1. Furnizues

1.1. Furnizues: Universiteti i Evropës Juglindore - Tetovë

2. Lënda e furnizimit

2.1. Inxhenjering komplet për instalimin e stabilimentit fotovoltaik me kapacitet prej 100 KW në një nga pjesët e hapësirës për parkim në kampusin e Universitetit të EJL.

Hapësira për parkim është ndërtuar dhe funksionon (detaje më të hollësishme më poshtë në këtë tekst), por për arsye se mungon dokumentacioni, para se të fillohet me instalimin e panelëve duhet të përfundojnë të gjitha aktivitetet lidhur me urbanizimin e hapësirës për parkim. Kjo thirrje publike mbulon jo vetëm pjesën teknike lidhur me stabilimentin fotovoltaik, por edhe lejen e cila paraprakisht duhet të sigurohet.

Thirrja publike ndahet në tre pjesë:

- Pjesa 1: Përpunimi i projektit arkitektonik-urbanistik;
- Pjesa 2: Përpunimi i projektit fillestar me raport për revizion të kryer;
- Pjesa 3: Furnizimi dhe instalimi i stabilimentit fotovoltaik me të gjitha elementet, si dhe kyçja në rrjetin shpërndarës.

2.2. Lënda e furnizimit nuk është e ndashme. Furnizuesi mban të drejtën të diktoj dinamikën lidhur me implemnetimin e pjesëve të caktuara, varësisht nga kushtet.

2.3. Përshkrimi i furnizimit

Pjesa 1

Lokacion me bruto sipërfaqe prej rreth 8500 m², i cili gjendet në anën e majtë të hyrjes kryesore, brenda kampusit të Universitetit të EJL. Lokacioni është ndërtuar me të gjithë infrastrukturën në hapsirën për parkim (shtresë e asfaltuar, me shenjëzim të vendeve për parkim, në brendi me ujdhesa të gjelbëruara, shtigje për këmbësorë, ndriçim në tërë hapsirën). Parkingu është në përdorim. Nuk ekziston projekt për të njejtin dhe njëkohësisht procedura për marrje të pëlqimit nuk është përfunduar.

Gjatë përgatitjes të ofertës duhet të parashikohet se projekti nuk do të zgjidhet në mënyrë ideore, por duhet përgatitur projekt arkitektonik-urbanistik të pozicionit tanimë të realizuar, në të cilin projekti do të duhet vetëm teknikisht të përshtatet. Për këtë arsye, ofertuesit do të duhet të bëjnë matje në lokacionin e caktuar, si dhe të njejtin t'ia përshtatin projektit. Gjithashtu ofertuesit do të duhet të kontrollojnë edhe kadastrën nëntokësore e cila është pjesë e lokacionit të determinuar.

SHËNIM: TË GJITHË TË INTERESUARIT, PARA SE T'A PËRGATITIN OFERTËN TË VIJNË NË LOKACIONIN E CAKTUAR T'A SHOHIN GJENDJEN REALE.

Personi për kontakt lidhur me çështje teknike:

Darko Spirovski, telefon për kontakt: 00389 78 344 899, posta elektronike: d.spirovski@seeu.edu.mk

Për përgatitjen e projektit arkitektonik-urbanistik të lokacionit të paraparë, furnizuesi do t'i mundësojë realizuesit dokumentacionin në vijim:

1. Të dhëna lidhur me kampusin e Universitetit të EJK;
2. Elaborat me të dhëna numerike;
3. Certifikatë PUD;
4. Dëshmi për pronësi;
5. Në rast se duhet edhe kopje të PUD dhe kadastrën nëntokësore

Cili do dokument i cili do të mund t'i duhet realizuesit dhe që ligjërisht është i nevojshëm, por që nuk është përmendur në listën më lartë do të sigurohet nga furnizuesi.

Pjesa 2

Në bazë të projektit arkitektonik-urbanistik dhe kushtet e lokacionit, të përgatitet propozim-projekti për hapësirën për parkim për të mbuluar me panela fotovoltaik.

Është planifikuar që mbi hapësirën për parkim të instalohen panela fotovoltaik me kapacitet 100 KW, me qëllim të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar operatorit të telefonisë celulare VIP Maqedoni. Duke pasur parasysh edhe pamjen estetike, lokacioni i i panelëve do të jetë vetëm në pjesën ku parkohen veturat (rreth ujdhesave), por assesi në pjesën e rrugëve për automjete dhe këmbësorë apo hapësirën e gjelbëruar. Detajet rreth kësaj çështje, në mënyrë shtesë do të negociohen ndërmjet investitorit dhe realizuesit.

Mënyra e shtrimit të kabllave, pozita e kutive kryesore shpërndarëse dhe pajisjet tjera gjithashtu do të jenë lëndë e kontratave të mëtutjeshme.

Gjatë përgatitjes së projektit me rëndësi është që të merret parasysh momenti i mirëmbajtës së pajisjeve (para së gjithash qasja direkte për pastrim mekanik të panelëve).

SHËNIM: TË GJITHË TË INTERESUARIT, PARA SE T'A PËRGATITIN OFERTËN TË VIJNË NË LOKACIONIN E CAKTUAR T'A SHOHIN GJENDJEN REALE.

Personi për kontakt lidhur me çështje teknike:

Darko Spirovski, telefon për kontakt: 00389 78 344 899, posta elektronike: d.spirovski@seeu.edu.mk

Pjesa 3

Gjatë përzgjedhjes së llojit të pajisjeve mundet që kapaciteti i elementeve si dhe prodhuesi i të njëjtës të propozohet nga ofertuesit. Duhet të theksohet se oferta duhet në detaje të përshkruaj:

- Llojin e pajisjeve (panela fotovoltaik, invertor, konstrukcion metalik, elemente lidhëse)
- Modeli i pajisjeve
- Prodhuesi i pajisjeve
- Garancioni i pajisjeve
- Kapaciteti dhe karakteristikat e pajisjeve (për zërat për të cilat është e nevojshme)

- Sasia (paraqitur me njësi)
- Çmimi për njësi për copë
- TVSh (në përqindje dhe vlerë)
- Çmimi i përgjithshëm sipas pozicioneve

Në çmim duhet të përfshihen të gjitha shpenzimet-transport, doganim, instalimi i pajisjeve.

Praktikisht, stabilimenti fotovoltaik duhet të parashihet që të realizohet sipas principit „çelës në dorë”, me të gjitha elementet e duhura (panelë, inverter, konstruksion metalik, kablo, lidhje, etj.).

Ofertuesit duhet që në ofertë, në mënyrë eksplicite të përshkruajnë mënyrën e montimit të konstruksionit metalik bartës të panelëve, gjatë kësaj duhet të merret parasysh se i njëjti duhet të montohet në parkingun e ndërtuar dhe asfaltuar, në të cilin janë të definuar ujdhesat me sipërfaqe të gjelbëruar, me vende parkimi të shenjëzuar.

2.4. Thirrja është publike, me të drejte për pjesëmarrje të të gjithë operatorëve ekonomik të vendit dhe të huaj, të regjistruar për veprimtarinë e cila është lëndë e furnizimit.

2.5. Të gjithë të interesuarit me qëllim të përgatitjes sa më cilësore të ofertës, i ftojmë të vijnë në mbledhje ku në mënyrë të detajuar do t’u sqarohen aspektet praktike të kërkesës. Njëkohësisht jemi të gatshëm t’i përgjigjemi çdo pyetjeje.

Mbledhja do të mbahet më datë 11.07.2012, ora 10:00, në ndërtesën 304, kampusi i Universitetit të EJL, adresa bul. „Ilindenska” pn, 1200 Tetovë, Maqedoni.

3. Komunikimi

3.1. Të gjithë të interesuarit duhet t’a informojnë investitorin me shkresë, me të dhënat bazike të kompanive të tyre (emri i kompanisë, adresa, telefoni për kontakt, adresa e postës elektronike). Informatat duhet të dërgohen në postën elektronike: procurement@seeu.edu.mk

3.2. Më shumë detaje lidhur me thirrjen publike mund të merrni nëpërmjet postës eletroknike: procurement@seeu.edu.mk

4. Përmbajtja e ofertës

4.1. Oferta duhet të përmbajë: emër, adresë, selinë e ofertuesit, numri i xhirollogarisë, numri tatimor dhe banka deponuese;

- Vërtetime (certifikata) të dhënë nga organe kompetente, organizata dhe persona tjerë juridik përgjegjës për kontrollin e cilësisë me të cilën do të vlerësohet përshtatshmëria e prodhimit;

4.2. Oferta duhet të plotësohet në formularin e bashkangjitur në web faqen e Universitetit.

Çmimet duhet të jenë të paraqitura sipas pjesës së thirrjes publike, në njësi me detaje për secilin pozicion në kuadër të një pjese (në rast se pjesa ka më tepër pozicione). Në çmimet për njësi duhet të jenë të gjitha, çmimi bazë, transporti, puna rreth montimit, TVSh. Çmimi i përgjithshëm i thirrjes publike duhet të jetë total i të tre çmimeve. Në rast se operatori ekonomik është i huaj në ofertë duhet të jenë llogaritur të gjitha të dhënat,

në rast e ka të tilla, por që më lartë nuk janë përmendur në përshkrimin e përmbajtjes së ofertës.

4.3. Në qofte se si ofertues paraqitet person juridik ose fizik i huaj, oferta duhet të jetë e përkthyer në gjuhën maqedonase ose gjuhën shqipe, ndërsa çmimi mund të paraqitet me valutë tjetër (konvertibile) e cila llogaritet sipas listës së valutës te Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë (kursi i mesëm) i cili aplikohet në ditën e hapjes së ofertave.

4.4. Oferta duhet të përmbajë mënyrën e pagesës - definuar qartë.

4.5. Oferta duhet të ketë afat prej 120 ditësh.

5. Dokumentacion me të cilin ofertuesi dëshmon gjendjen ekonomike dhe financiare

- Dokument për veprimtari të regjistruar si dëshmi se është i regjistruar (për operator ekonomik) për kryerjen e veprimtarisë lidhur me lëndën e thirrjes publike, të lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë;

- Leje nga organi kompetent për punë (veprimtari) për operator ekonomik;

- Dokument për bonitet i lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë;

- Vërtetim se nuk është hapur procedurë falimentimi;

- Vërtetim se nuk është hapur procedurë për likuidim;

- Vërtetim se nuk i është kumtuar sanksion kundërvajtës - ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës, gjegjësisht ndalesë të përkohshme për kryerjen e veprimtarisë së veçantë - Vërtetim nga gjykata;

- Vërtetim nga Drejtoria për të hyra publike për tatime të paguara, kontribute dhe detyrime të tjera;

- Deklaratë se në 5 vitet e fundit nuk është kumtuar aktgjykim i plotfuqishëm për pjesëmarrje në organizata kriminale, korrupsion, mashtrim ose larje të parave;

Dokumentet e lartpërmendura nuk duhet të jenë më të vjetra se 6 muaj, ndërsa dorëzohen në original ose kopje të noterizuara.

Operatori ekonomik i huaj i dorëzon dokumentet e lartpërmendura të lëshuara nga institucione përkatëse të huaja.

Raporti i revizorit dhe dokumentet tjera të lëshuara nga institucioni përkatës nga vendi i huaj dhe në gjuhë të huaj duhet të jete i përkthyer në gjuhën shqipe ose gjuhën maqedonase dhe i vërtetuar nga përkthyes gjyqësor.

Ofertat të cilat nuk do t'i përmbajnë dokumentet e lartë përmendura do të llogariten si të pakompletuara dhe të njejtat nuk do të shqyrtohen.

6. Dokumente me të cilat ofertuesi dëshmon aftësinë teknike ose profesionale

- Autorizime për të punësuarit lëshuar nga Oda e arkitektëve të autorizuar dhe inxhinierëve të autorizuar të Maqedonisë;

- Kompania të ketë së paku Licencë për projektim të ndërtimeve të kategorisë së dytë;

- Listë të furnizimeve të kryera për furnizimin për të cilin dorëzohet ofertë, të kryera në tre vitet e fundit, me vlera, data dhe shfrytëzuesit (listë referuese) sipas kushteve nga dokumentacioni i tenderit;

- Vërtetim nga furnizuesi për furnizime të kryera për tre vitet e fundit për përshtatshmërinë, kryerjen në kohë dhe me cilësi të furnizimit nga ofertuesi.

7. Kriteret për zgjedhjen e ofertës më të përshtatshme:

- Cilësia;
- Çmimi;
- Garancioni;
- Referenca;
- Mënyra dhe afati i pagesës;
- Afati i furnizimit;

Në bazë të kriterëve të lartë përmendura zgjidhet oferta më e përshtatshme.

8. Mënyra dhe afati i dorëzimit të ofertave

Ofertuesi duhet ta dorëzojë ofertën në një kopje origjinale në zarf të mbyllur, në të cilën duhet të jete shenja „Mos e hap”, të jetë e firmosur nga ana e përgjegjësit të ofertuesit. Në zarfën e mbyllur duhet të ketë edhe dy zarfa tjera, të mbyllura. Njëra nga zarfat e mbyllura e përmban ofertën, me shenjën „Oferta”, ndërsa zarfi tjetër përmban dokumentacionin e nevojshëm, me shenjën „Dokumentacioni”, në të cilën duhet të jetë edhe adresa e saktë e ofertuesit.

Ofertat të cilat nuk i përmbajnë të gjitha të dhënat të kërkuara në thirrjen, gjegjësisht në të cilat nuk është bashkangjitur dokumentacioni i kërkuar do të llogariten si të pakompletuara dhe nuk do të shqyrtohen.

Afati për dorëzimin e ofertave është deri më 20.07.2012 (e premte), ora 16:00

Ofertat të cilat do të dorëzohen pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Ofertat mund të dorëzohen nëpërmjet postës në adresën: Universiteti i Evropës Juglindore, „Ilindenska” pn 1200 Tetovë ose të dorëzohen në arkivin e Universitetit të EJK, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

9. Dispozitat përfundimtare

9.1. Ofertat e dorëzuara pas kalimit të afatit dhe të cilat nuk janë të përgatitura sipas thirrjes publike nuk do të shqyrtohen.